

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leonita Lajçi procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve: F.H.1. për shkak të veprave penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, të akuzuarit E.H. dhe F.H.2. që të dy për shkak të veprës penale sulm në tentativë nga neni 187 par.2 e në lidhje me par.1 dhe 28 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ato të mbrojtësit të akuzuarit E.H. dhe ankesën e të akuzuarit F.H.2., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan PKR.nr.181/16 datë 23.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 01.10.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan përkitazi me të akuzuarin F.H.1. vetëm për vendimin mbi dënim, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.181/16 datë 23.07.2018, ashtu që të akuzuarit F.H.1. për veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së kjo gjykatë e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro. Pjesa tjetër e aktgjykimit ngel e paprekur.

II.Refuzohen si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjilan përkitazi me të akuzuarit E.H. dhe F.H.2. si dhe për bazat tjera ankimore, dhe ato të mbrojtësit të akuzuarit E.H. dhe të akuzuarit F.H.2..

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan me aktgjykimin PKR.nr. në Gjilan PKR.nr.181/16 datë 23.07.2018, të akuzuarin F.H.1. konform nenit 364 par.1 nënpar.3 dhe nenit 454 par.1 të KPRK-së e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Shpenzimet lidhur me këtë vepër penale, mbesin barrë e mjeteve buxhetore të KGJK-së. Të akuzuarit F.H.1., gjykata e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së ndërsa të akuzuarit E.H. dhe F.H.2. për shkak të veprës penale sulm në tentativë nga neni 187 par.2 lidhur me par.1 dhe 28 të KPRK-së. Të akuzuarit F.H.1. i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të akuzuarit E.H. dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet me kusht që në afat prej 2 (dy)viteve i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale. Të akuzuarit F.H.2. dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet me kusht që në afat prej 2 (dy) viteve i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale. Janë

detyruar të akuzuarit që gjykatës t'ia paguajnë shumat prej nga 50 euro, secili veç e veç, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë kanë paraqitur:

- Prokuroria Themelore në Gjiçan për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit ta abrogojë aktgjykimin e ankimuar përkitazi me veprën penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe lëndën ta kthejë në ri gjykim apo të akuzuarin F.H.1. ta shpall fajtor për këtë veprë penale, ndërsa ta ndryshojë aktgjykimin në pjesën mbi dënimin në raport me të akuzuarit për veprat penale si në dispozitivin nr II dhe III të aktgjyqimit të atakuar ashtu që të akuzuarve të ju shqiptojë dënim meritore me burg efektiv.

-I akuzuari F.H.2. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarin ta lirojë nga përgjegjësia penale apo lëndën ta kthejë në rigjykim.

-Mbrojtësja e të akuzuarit E.H. av.J.M.S. për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarin E. ta lirojë nga akuza apo të njëjtin ta anulojë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit F.H.1. av.M.M ka paraqitur përgjigje në ankesën e Prokurorisë me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta vërtetojë sa i përket të akuzuarit F.H.1, ndërsa sa i përket veprës së dytë asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së aktgjykimi të ndryshohet dhe i padituri të udhëzohet në kontest civil, të cilin do ta realizojë nga kompania e sigurimeve, apo të njëjtin ta anulojë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.394/18 të dt. 06.09.2018 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjiçan, aktgjykimi i ankimuar të anulohet sa i përket veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ndërsa sa i përket pikës II dhe III aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarve të ju shqiptohen dënime me burgim. Të refuzohen përgjigja në ankesën e Prokurorisë e parashtuar nga mbrojtësi i të akuzuarit F.H.1., ankesa e mbrojtësit të akuzuarit E.H. dhe ankesa e të akuzuarit F.H.2. si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesat nuk janë të bazuara

Prokuroria Themelore në Gjiilan ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.10 të KPPK-së. Kjo shkelje qëndron në faktin se gjykata në raport me veprën penale sulm në tentativë të përshkruar si në pikën III të aktgjykimit, edhe pse të akuzuarit i ka shpallur fajtor për këtë veprë penale, në pjesën e arsytimit lidhur me këtë veprë penale në kundërshtim me pjesën përshkruese të gjendjes faktike si dhe kualifikimit të veprës penale, në pjesë të arsytimit konstaton se në rastin konkret kemi të bëjmë jo me kryerjen e veprës penale të sulmit në tentativë por me veprën penale sulmi nga neni 187 par.2 e lidhur me par.1 të KPRK-së, gjë që jo vetëm që është në kundërshtim me dispozitivin III të aktgjykimit por madje Gjykata me rastin e vendosjes së kësaj çështje penale, gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike kur të akuzuarin F.H.1. e ka liruar nga akuza për s hak të veprës penale nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Prokuroria po ashtu konsideron se dënimet e shqiptuara për ta akuzuarit F.H.1., E.H e F.H.2. janë tejet të ulëta, nuk i përkasin peshës së veprave penale të kryera nga të akuzuarit dhe vetë rrethanave në të cilat të pandehurit i kanë kryer këto vepra penale.

Mbrojtësja e të akuzuarit E.H. av.J.M. me ankesë konsideron se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi se dispozitivi i të njëjtit është në kundërshtim të thellë me arsytimin dhe se nuk janë dhënë arsyet e duhura për heshtjet vendimtare në të cilat të meta kujdeset sipas detyrës zyrtare edhe gjykata e shkallës së dytë meqë i njëjti si i ketillë është i qëndrueshëm. Gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, nuk ekzistojnë elementet e figurës penale të cilën aktakuza i'a vë në barrë , meqë e njëjta nuk gjen mbështetje faktike dhe ligjore e që shihet nga shkresat e lëndës. Në rastin konkret edhe ligji është zbatuar gabimisht nga fakti se në veprimet e të akuzuarit E. nuk ekzistojnë veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë elementet e veprës penale sulm në tentativë nga neni 187 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 28 të KPP-së.

I akuzuari F.H.2. me ankesën e paraqitur konsideron se aktgjykimi është marrë me shkelje të ligjit të procedurës kur dispozitivi i të njëjtit është në kundërshtim me arsytimin dhe nuk janë dhënë arsyet për çështjet e rëndësishme për cka kujdeset sipas ligjit Gjykata e Apelit. Aktakuza përmban parregullsi të shumta dhe se teza e të njëjtës nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme. Gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Me marrjen në pyetje të akuzuarve, dëshmitarëve si dhe shtjellimit të provave të propozuara nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë tiparet e veprës penale të cilën aktakuza i vë në barrë pasi e njëjta nuk gjen mbështetje në shkresat e lëndës.

Mbrojtja e të akuzuarit F.H.1. me përgjigjen në ankesë konsideron se gjykata në praninë e fakteve dhe provave të lartpërmendura me arsye ka nxjerrë konkludimin se në veprimet të akuzuarit F.1. nuk përmbahen elementet e figurës së veprës penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së e këto rrethana i vërteton edhe dëshmitari okular R.R.. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të akuzuarin F.1. e ka liruar nga aktakuza për këtë veprë, ndërsa sa i përket veprës së dytë asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, këtë dëm mbrojtja mendon se duhet ta kompensojë kompania e sigurimeve ku makina e të akuzuarit F.1. ka qenë e siguruar.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesën e Prokurorisë, mbrojtjes si dhe atë të akuzuarit F.H.2., shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi

i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara me ankesë por as shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare është e obliguar ti shqyrtojë. I njëjti ka të paraqitura arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, është paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palës mbrojtëse si dhe arsyet me të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike e veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarve. Gjykata e shkallës së parë në aktgjykim ka dhënë arsyet për faktet vendimtare, ka arsyetuar secilën provë veç e veç duke i ndërlidhur me njëra tjetrën dhe duke e vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Deri te kjo gjendje e vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë erdhi në bazë të provave materiale dhe jo materiale dhe atë duke dëgjuar të dëmtuarin-dëshmitarin S.M. i cili lidhur me vendin, kohën, mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale ka qenë i qartë dhe konkret e që ndërlidhet edhe me dëshminë e dëshmitarës Q.H., dëshmitarit H.S., R.M., J.B. si dhe provat materiale fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes dhe raporti i oficerit i datës 23.05.2016 si dhe janë dëgjuar mbrojtjet e të akuzuarve ashtu që me të drejtë nga këto prova pa mëdyshje u vërtetua se nuk mund të vërtetohet dashja e të akuzuarit F.H.1. për të kryer veprën penale të tentim vrasjes nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së pasi kjo nuk u provua me asnjë provë të administruar në shqyrtimin kryesor. Nuk është kontestuese se i akuzuari me veturën e tij Opel Kadet i është vënë në ndjekje të dëmtuarit S. që ka qenë në veturën e tij Pasat dhe se kur kanë arritur te udhëkryqi i zjarrfikësave e ka goditur veturën Pasat me veturën e tij duke i shkaktuar dëm material por pa lëndime dhe mënyra në të cilën është kryer ky veprim i kundërligjshëm nuk përmbajnë elemente të veprës penale të vrasjes në tentativë e aq më tepër kur në një formë të tillë të veprimeve nuk kemi të lënduar përveç dëmtimeve materiale të veturave ndërsa elementet e tentim vrasjes sic u cek më lart mungojnë. E tërë ngjarja që ka ndodhur nuk është kontestuese por ajo që mbetet kontestuese janë vetëm veprimet e të të akuzuarit për të cilat Prokuroria mendon se përmbajnë elemente të tentim vrasjes e që nga ato që u thanë më lart kjo gjykatë vlerësoi të njejtën gjendje faktike sikurse edhe gjykata e shkallës së parë. Sa i përket asaj se në veprimet e këtij të akuzuari a qëndrojnë elementet e veprës penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e qarta e të cilat si të tilla i pranon edhe kjo gjykatë pa dashur që edhe një herë ti përsërisë të njëjtat. Ndërsa edhe pse i akuzuari nuk ka ushtruar ankesë për pjesën dënuese gjegjësisht për veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, kjo gjykatë të njejtën e vlerësoi sipas detyrës zyrtare dhe ka ardhur në përfundim se me provat e administruara u vërtetua se në veprimet e të të akuzuarit F.H.1. qëndrojnë elementet e veprës penale nga neni 333 par.1 të KPRK-së duke u vërtetuar në tërësi gjendja faktike dhe në këtë drejtim nuk kemi as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal. Përkitazi me dispozitivin nën pikën III të aktakuzës e që ka të bëjë me të akuzuarit E.H. dhe F.H.2., ankesat e tyre janë të pabazuara pasi që përveç të akuzuarit S.M. i cili ka përshkruar ndjekjen e tij nga ana e të akuzuarve deri te mekaniku me emrin S2. duke e gjuajtur me copëza betoni duke mos e goditur, e njëjta vërtetohet edhe me deklaratën e dëshmitarit H.S. por pjesërisht edhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarit që kanë pranuar se kanë pasur copëza betoni në dorë ndërsa i akuzuari F.2. ka thënë se “Baba E... kur ka dalë prej veturës ka pasur në dorë edhe një shufër metalike”, ashtu që bazuar në këto prova pa mëdyshje u vërtetua se në veprimet e të akuzuarve qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilat ata janë shpallur fajtor dhe janë gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë dhe mbrojtjes janë të pa bazuara. Nuk qëndron pretendimi i Prokurorisë se në rastin konkret është shkelur ligji penal në favor të akuzuarit me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë në shumë prej 200 euro, pasi që për veprën penale nga neni 333 par.1 të KPRK-së parashihet dënimi me burgim në kohëzgjatje deri në 1 vit, pasi që gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar këtë vendim duke aplikuar nenin 76 pika 1.7 për zbutjen e dënimeve, i cili parasheh që nëse për veprën penale nuk është paraparë masa më e ulët e dënimit, atëherë mund të shqiptohet dënimi me gjobë në vend të dënimit me burgim. Në ankesën e Prokurorisë theksohet po ashtu se dënimet janë tejet të ulëta dhe nuk i përkasin peshës së veprave penale të kryera dhe nuk është bërë vlerësim i drejtë i rrethanave lehtësuese dhe rënduese dhe në kundërshtim me dispozitat për uljen e dënimit, ndërsa mbrojtësja e të akuzuarit E.H. dhe i akuzuari F.H.2. edhe pse kanë paraqitur si baza ankimore vendimin mbi dënim të njëjtin nuk e kanë arsyetuar me arsyetim se nuk është vërtetuar gjendja faktike dhe se në veprimet e të të akuzuarve nuk qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën ata janë shpallur fajtor. Mirëpo, kjo gjykatë përkitazi me të akuzuarin F.H.1. vlerëson se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë është tejet i ulët duke pasur parasysh veprën penale të kryer, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale për cka edhe aprovoi ankesën e Prokurorisë në këtë drejtim ndërsa përkitazi me të akuzuarit E. dhe F.H.2., kjo gjykatë vërtetoi se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje të pretenduara nga mbrojtja ndërsa duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që i ka konstatuar dhe vlerësuar drejtë gjykata e shkallës së parë, si: më parë të pa dënuar, janë familjarë, të gjendjes së dobët ekonomike si dhe në mungesë të rrethanave rënduese vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj E. dhe F.H.2. nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.416/2018, më 01.10.2018

Procesmbajtësi,
Leonita Lajçi

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Have Haliti _____

PAGE

PAGE 2